



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 04, Datë 13.01.2022

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “E.T.H-H”
SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NR. 205, SERIA PV12K, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 pikat 1 dhe 3 dhe nenit 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96 datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.01.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 164/1 prot., datë 29.12.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes “Mbi mos fillimin e procedurës për kërkesën e shoqërisë E.T.H-H sh.p.k. për modifikimin e licencës nr. 205, Seria PV12K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “E.T.H-H” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1152/1 prot., datë 17.12.2021, ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, nga 1300 kW në 1580 kW në total për HEC Helmes 1 dhe Helmes 2.
- Shoqëria ka përcjellë në ERE shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 349/5 prot., datë 06.10.2017, për mriatimin e projektit të zbatimit dhe Oponencën teknike nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) me shkresën nr. 5123 prot., datë 23.06.2017.
- Shoqëria “E.T.H-H” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 205, Seria PV12K, miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 117, datë 22.08.2012.
- Shoqëria nuk ka kryer pagesën e aplikimit në llogari të ERE-s për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të nenit 8 pika 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, në të cilin citohet se: “Aplikuesi duhet të

kryejë pagesën për aplikim në momentin e paraqitjes së aplikimit, përcaktuar në aneksin - A- të kësaj rregullorje”.

- Në kushtet kur nuk është kryer pagesa e aplikimit nga shoqëria, dokumentaconi i pjesshëm i depozituar bashkëlidhur kësaj kërkesë nuk mund të merret në shqyrtim nga ana e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “E.T.H-H” sh.p.k. me nr. 205 Seria PV12K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI